



VENDIM
Nr.89 Datë 15.11.2010

PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “ANSARA KONÇESION” SH.P.K

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 gërma “a”, 9, 13 pika 1, gërma “a”, 15 pika 3, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, dhe nenit 13 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 15.11.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ANSARA KONÇESION” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

Dhe konstatoi se:

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s lidhur me liçensimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- Formatit të aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Mungesa e Dokumentacionit që ka të bëjë me paraqitjen e Lejes Mjedisore nga organet përkatëse është në proces përfundimi. (neni 9 pika 4.1.5, gërma “c”).

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Liçensimin e shoqërisë “ANSARA KONÇESION” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Labinot – Mal - Elbasan”, me fuqi 0.25

MW me kusht qw Shoqwrria “ANSARA KONÇESION” sh.p.k, tw dorwzowjw “Lejen Mjedisore”, brenda 90 ditwve nga data e miratimit tw liçensws.

2. Afati i vlefshmerisë së licensës të jetë 30 vjet.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjeherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar NEPRAVISHTA